



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE
TË BRENDSHME

**RAPORTI I MONITORIMIT
TË LEJEVE TË QËNDRIMIT DHE LEJEVE UNIKE
TË LËSHUARA/ REFUZUARA
PËR VITIN 2025**

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje
2. Qëllimi i raportit
3. Metodologjia dhe burimet e informacionit
4. Analiza statistikore e aplikimeve dhe lejeve të qëndrimit/unike
 - 4.1 Numri i aplikimeve për leje qëndrimi/unike
 - 4.2 Numri i lejeve të lëshuara
 - 4.3 Krahاسimi i lejeve të qëndrimit/unike të lëshuara për periudhën 2024–2025
5. Analiza e refuzimeve të aplikimeve
 - 5.1 Numri i lejeve të qëndrimit/unike të refuzuara
 - 5.2 Arsyet kryesore të refuzimit
6. Problematikat e konstatuara gjatë shqyrtimit të aplikimeve
7. Rekomandime

1. HYRJE

Raporti Vjetor 2025 “Për monitorimin e procedurave dhe numrit të lejeve të qëndrimit dhe lejeve unike të lëshuara apo refuzuara”, është hartuar nga Sektori i Politikave të Politikave të Kufirit dhe Migracionit në Drejtorinë e Politikave Kundër Krimit të Organizuar, Migracionit dhe Azilit, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në zbatim të pikës 5, të nenit 4 dhe nenit 86 të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt”, i ndryshuar, si dhe të urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 185, datë 28.09.2022 “Për përcaktimin e procedurave të monitorimit të lejeve të qëndrimit dhe lejeve unike”.

Raporti është hartuar mbi bazën e informacionit të përcjellë nga Drejtoritë Vendore për Kufirin dhe Migracionin të qarqeve Tiranë, Durrës, Shkodër, Gjirokastër, Vlorë, Korçë dhe Kukës.

2. QËLLIMI I RAPORTIT

Ky raport ka për qëllim monitorimin e procedurave të aplikimit dhe trajtimit të lejeve të qëndrimit/unike, evidentimin e numrit të shtetasve të huaj që aplikojnë dhe pajisen me leje qëndrimi/unike si edhe evidentimin e numrit të aplikimeve të refuzuara dhe analizimin e shkaqeve përkatëse.

Raporti përmbledh problematikat e identifikuar gjatë zbatimit të legjislacionit për të huajt nga DVKM-të në rang vendi, si edhe jep rekomandime për përmirësimin e proceseve administrative nëpërmjet mirë koordinimit ndërinstitucional.

3. METODOLOGJIA DHE BURIMET E INFORMACIONIT

Raporti bazohet në të dhënat statistikore të raportuara nga Drejtoritë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, informacionet operative dhe administrative të sistemit FER si edhe në analizën krahasimore të viteve 2024–2025.

4. ANALIZA STATISTIKORE E APLIKIMEVE DHE LEJEVE TË QËNDRIMIT/UNIKE

4.1 Numri i aplikimeve për leje qëndrimi/unike

Gjatë vitit 2025, numri total i shtetasve të huaj që aplikuan për leje qëndrimi/unike arriti në **41,129 persona**, krahasuar me **23,771 persona** gjatë vitit 2024. Shprehur në përqindje, në vitin 2025 kemi një rritje me 73 % të aplikimeve krahasuar me vitin 2024.

Numri më i lartë i aplikimeve është regjistruar në:

- DVKM Durrës – 16,436 aplikime;
- DVKM Tiranë – 15,915 aplikime.

Ndërkohë, vetëm 6 aplikime rezultojnë ende në proces shqyrtimi.

4.2 Numri i lejeve të qëndrimit/unike të lëshuara

Gjatë vitit 2025 janë lëshuar gjithsej **23,004 leje qëndrimi/unike**, ndërsa në vitin 2024 janë lëshuar **12,143 leje qëndrimi/unike**. Shprehur në përqindje, në vitin 2025 kemi një rritje me 89 % të të huajve të pajisur me leje qëndrimi/unike, krahasuar me vitin 2024.

Numri më i lartë i autorizimeve të lëshuara për vitin 2025 është realizuar nga:

- DVKM Durrës – 7,726 autorizime;
- DVKM Tiranë - 7,725 autorizime;
- DVKM Vlorë – 4, 641 autorizime.

DVKM Korçë ka regjistruar numrin më të ulët të autorizimeve, me 238 raste.

4.3 Krahasimi i lejeve të qëndrimit/unike të lëshuara, për periudhën 2024–2025

Tabela nr.1: Situata e trajtimit me leje qëndrimi dhe leje unike në Shqipëri, për vitet 2024-2025

Nr.	DVKM	Nr. Shtetasve të huaj të pajisur me leje qëndrimi/unike 2024	Nr. Shtetasve të huaj të pajisur me leje qëndrimi/unike 2025
1	Tiranë	5,501	7,725
2	Durrës	2,941	7,726
3	Vlorë	2,112	4,641
4	Shkodër	1,228	1,879
5	Kukës	183	327
6	Korçë	95	238
7	Gjirokastrë	83	468
	Total	12,143	23,004

Burimi: Policia e Shtetit

Tabela nr.2: Situata e trajtimit të aplikimeve dhe miratimit për pajisjen me leje qëndrimi dhe leje unike në Shqipëri, për vitet 2024-2025

Nr.	DVKM	Nr. Shtetasve të huaj që kanë aplikuar për tu pajisur me leje qëndrimi/unike 2024	Nr. Lejeve qëndrimi/unike të miratuara 2024	Nr. Shtetasve të huaj që kanë aplikuar për tu pajisur me leje qëndrimi/unike 2025	Nr. Lejeve qëndrimi/unike të miratuara 2025
1.	Tiranë	12,616	5,501	15,915	7,725
2.	Durrës	6,554	2,941	16,436	7,726
3.	Vlorë	2,669	2,112	4,093	4,641
4.	Shkodër	1,316	1,228	3,109	1,879
5.	Kukës	193	183	358	327
6.	Korçë	256	95	575	238
7.	Gjirokastrë	167	83	643	468
	Total	23,771	12,143	41,129	23,004

Burimi: Policia e Shtetit

5. ANALIZA E REFUZIMEVE TË APLIKIMEVE

5.1 Numri i lejeve të qëndrimit/unike të refuzuara

Gjatë vitit 2025 janë refuzuar gjithsej **12,206 aplikime**, krahasuar me **9,246 aplikime** të refuzuara gjatë vitit 2024.

DVKM-të me numrin më të lartë të refuzimeve rezultojnë:

- Tiranë – 6,826 refuzime;
- Durrës – 3,845 refuzime.

Numri më i ulët i refuzimeve është regjistruar në DVKM Kukës, me 25 raste.

5.2 Arsyet kryesore të refuzimit

Refuzimet kanë ardhur kryesisht si pasojë e:

1. mungesës së vizës;
2. mungesës së miratimit nga AKPA;
3. mungesës së informacionit ose dokumentacionit;
4. tejkalimit të afateve ligjore;
5. ndërprerjes së kontratës së punës;
6. aplikimeve jashtë afateve të rinovimit;
7. mospërputhjes së adresës së akomodimit me juridiksionin përkatës të DVKM-së.


Tabela nr. 3: Situata e trajtimit me leje qëndrimi dhe leje unike në Shqipëri, për vitin 2025

Nr.	DVKM	Nr. Shtetasve të huaj që aplikojnë për leje qëndrimi/unike	Nr. Shtetasve të huaj të pajisur me leje qëndrimi/unike	Nr. Lejeve të qëndrimit/unike të refuzuara	Nr. Lejeve në proces
1.	Tiranë	15,915	7,725	6,826	–
2.	Durrës	16,436	7,726	3,845	–
3.	Vlorë	4,093	4,641	137	
4.	Shkodër	3,109	1,879	917	–
5.	Korçë	575	238	321	
6.	Gjirokastrë	643	468	135	–

7.	Kukës	358	327	25	6
	Total	41,129	23,004	12,206	6


Burimi: Policia e Shtetit

Grafik nr.1: Situata e trajtimit të aplikimeve për leje qëndrimi në Shqipëri, për vitin 2025



Burimi: Policia e Shtetit

Grafik nr.2: Situata e trajtimit të aplikimeve për leje unike në Shqipëri, për vitin 2025



Burimi: Policia e Shtetit

6. PROBLEMATIKAT E KONSTATUARA

Nga analiza e të dhënave dhe raportimet e DVKM-ve gjatë vitit 2025, janë evidentuar problematika të shumta që ndikojnë në procesimin e aplikimeve për leje qëndrimi dhe leje unike:

1. Mos konfigurimi i plotë i sistemeve elektronike;
2. Dublikimi në procedurat administrative;
3. Cilësia e dobët e dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesit;
4. Problematika procedurale gjatë aplikimit;

7. REKOMANDIME

Nga analiza e të dhënave për vitin 2025 rezulton se është e nevojshme ndërmarrja e një sërë masash strategjike për adresimin e problematikave të evidentuara gjatë zbatimit të procedurave dhe funksionimit të sistemeve për trajtimin e aplikimeve të shtetasve të huaj. Në këtë kuadër, rekomandohet, si më poshtë vijon:

1. Përmirësimi i konfigurimit dhe ndërveprimit të sistemeve sa më optimale;
2. Përmirësimi i gjurmimit në kohë reale të aplikimeve për leje qëndrimi/unike;
3. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për unifikimin e të dhënave migratore;
4. Rritja e efikasitetit administrativ dhe shmangia e vonesave procedurale.